

Bazuar në Vendimin për shpalljen e konkursit për nxënës të arsimit fillor dhe të mesëm me rastin e Ditës së Sigurimit - 1 Nëntorit dhe aprovimit të fondeve me numër 02-5341/2 me datë 21.9.2020, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Republika e Maqedonisë së Veriut shpall

KONKURS

për nxënës të arsimit fillor dhe të mesëm me rastin e Ditës së Sigurimeve - 1 Nëntorit

- Tema dhe kushtet e konkursit për nxënësit e shkollave fillore

Nxënësit e shkollës fillore nga klasa e 1-rë deri në klasën e 5-të mund të paraqesin vepër arti (vizatim) për temën e caktuar:

"Vepër arti -" Sigurimi si mbrojtje e së ardhmes time "

Nxënësit e shkollës fillore, nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të mund të paraqesin vepër letrare për temën e caktuar:

Vepër letrare - "Polica e sigurimit është investimi im"

Për veprat e përzgjedhura si më të mira për nxënësit e shkollave fillore do të jepen gjithsej 6 çmime, si më poshtë:

- 3 çmime për veprat më të mira artistike - vizatim/vizatim digjital për nxënës nga klasa e 1-rë deri në klasën e 5-të;
- 3 çmime për veprat më të mira letrare – vjershë për nxënësit nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të;

Nxënësve, veprat e të cilëve janë vlerësuar do të shpërblehen me një çmim monetar me vlerë prej 3.000,00 denarësh për veprën më të mirë letrare dhe artistike, duke depozituar çmimin monetar në një bankë të zgjedhur prej tyre.

- Tema dhe kushtet e konkursit për nxënësit e shkollave të mesme

Nxënësit e shkollave të mesme mund të marrin pjesë në konkurs duke paraqitur një vepër letrare - tregim/ese me temën e caktuar:

"Jeta është plot surpriza, sigurimi është siguria dhe mbrojtja ime financiare"

Tregimi/eseja duhet të ketë maksimum 1,800 fjalë me përmbajtje për një qëndrim personal ndaj rolit të sigurimit, duke u fokusuar në çështje të tilla si: njohuritë e të rinjve rreth sigurimeve, si të blejnë sigurime dhe të kenë një policë sigurimi, të mendojnë për nevojën e arsimit dhe edukimit financiar, roli i sigurimeve në administrimin e rrezikut, roli i sigurimeve në ekonomi, sjellja e të rinjve dhe shprehitë familjare ndaj sigurimeve, dhe aspekte të tjera.

Për punimet e përzgjedhura si më të mira, nxënësve nga arsimi i mesëm do t'u jepen gjithsej 3 çmime për tregimin/esenë më të mirë.

Nxënësve, veprat e të cilëve janë vlerësuar do të shpërblehen me një çmim monetar me vlerë prej 6.000,00 denarësh, duke depozituar çmimin monetar në një bankë të zgjedhur prej tyre.

Kushtet e përbashkëta që zbatohen edhe për nxënësit në arsimin fillor dhe atë të mesëm:

Afati i fundit për dorëzimin e punimeve është data 20 tetor 2020.

Ju lutemi nënshkruani punimet Tuaja, me informacionin e mëposhtëm të detyrueshëm:

<ul style="list-style-type: none">- Emri dhe mbiemri i nxënësit,- Emri i shkollës ku nxënësi mëson (klasa/viti /) komuna/fshati/qyteti),- Emri dhe mbiemri i prindit/kujdestarit me adresën e banimit, dhe- Telefoni i kontaktit të prindit/kujdestarit/mësuesit/profesorit.

Mënyra e dorëzimit të punimeve:

Të gjitha punimet (vizatim, poezi, tregim/ese) mund të dorëzohen direkt në Arkivin e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve ose me postë. Veprat letrare (poezi, tregim/ese), si dhe vepra e artit (ekskluzivisht vizatime të bëra në një pajisje digjitale) mund të dorëzohen në mënyrë elektronike në adresën e postës elektronike të mëposhtme:

contact@aso.mk

Adresa për dorëzim me postë me shënimin:

"Për konkursin me rastin e Ditës së Sigurimeve - 1 Nëntorit"

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve

Rr. Maqedonia nr. 25, Pallati Lazar Pop Trajkov, kati i 5-të, 1000 Shkup

Republika e Maqedonisë së Veriut

Punimet e paraqitura do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni profesional për përzgjedhjen e veprës më të mirë të artit - vizatim, veprën më të mirë letrare - poezi për nxënësit e shkollës fillore dhe veprën më të mirë letrare - tregim/ese për nxënës të shkollës së mesme.

Lista e nxënësve të vlerësuar me çmim do të publikohet jo më vonë se data 31 tetor 2020, në faqen e internetit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve www.aso.mk dhe www.edukacija.aso.mk

Për informacione më të hollësishme, Ju lutemi kontaktoni në e-mailin e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve contact@aso.mk